




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-2226/23 datë:20.01.2023



Npi – 01/40 datë: 27.01.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.01.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 27.01.2023, (e premtë) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Drejtori: DZHE, z.Kastriot Shabani, DPUGKJ, z.Grejtalb Emini, DSHMS, z.Isa Haxhiu, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati, zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi, znj.Gentiana Mehmeti, asistente e Kryesuesit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjafthueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.12.2022,
2. Diskutim për Organizimin e 15 janarit të Masakrës së Reqakut, (Pikë Shtesë)
3. Pyetje – përgjigje,
4. Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, (pas diskutimit publik)
5. Raporti vjetor financiar i Komunës së Shtimes për vitin 2022,
6. Propozim-Vendim për ndarjen 100 € për Nënët-Lehona për vitin 2023.
7. Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026,
8. Draft-Plani i Punës të Kuvendit për vitin 2023,
9. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit për 2023,
10. Informatë për punën e KKSBB-së gjatë vitit 2022,
11. Raport i punës së Kuvendit për vitin 2022,
12. Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimi për rendin e ditës.

z.Adem Ramadani; Përshëndetje, në emër të PDK-së pajtohemi me rendin e ditës. Propozojë që të futet si pikë e dytë e rendit të ditës “Organizimi i Përvjetorit të Masakrës së Reqakut”.

z.Reshat Mujota; Kërkojë që te pika 4 mos të jetë raport por informatë, sepse nuk është si i tillë. Te propozimi i Ademit nuk e pata të qartë formulimin.

z.Adem Ramadani; Unë po dua me diskutua për “15 Janarin” rreth organizimit: “Diskutim për 24 vjetorin e Masakrës së Reqakut”.

z.Përparim Ramusa; Ne si PDK-ë kërkojmë që të futet si pikë shtesë e dytë “Keq menaxhimi i organizimit të 15 janarit të masakrës së Reqakut”.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, po ndërlidhem me propozimin e kolegut për me diskutua për “15 Janarin”, mendoj se ka çka me u diskutuar. Por siç dihet organizimi ka qenë në zyrën e Kryeministrat ajo e ka organizuar dhe unë nuk mendojë se duhet me diskutuar sot ne në këtë Kuvend.

z.Adem Ramadani; E di që ka pas “Këshill Organizativ” që kam qenë edhe vetë. Më mirë është me diskutuar sot ne këtu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; zotëri Ferati a nevojitet me u aprovuar ky raport?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Ky raport duhet të votohet dhe mundë të diskutohet se në cilat pika duhet të përmirësohet.

z.Reshat Mujota; Raporti duhet me qenë analistik, le të ma dëshmon Bujari se është analistik. Ne votojmë për projekte dhe dua me dit a janë shkuar mjetet te ato projekte. Unë kështu nuk mundem me votua.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Raporti mundë të ketë edhe pjesë shtesë, vitin e kaluar e keni votuar në këtë format. Materialin e keni marrë dhe këtu janë përfshirë të gjitha kategoritë Ekonomike.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kemi dy propozime Adem Ramadani dhe Reshat Mujota.

z.Reshat Mujota; Unë pata kërkesë jo propozim në mirëkuptim me u bë informatë, Bujari tha duhet raport atëherë le të jetë raport.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mbetet vetëm një propozim i Adem Ramadanit si pikë e dytë shtesë.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit, që është dërguar me material.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 12 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 7 vota “Abstenim”** miratoi rendin e ditës me propozimin e pikës së 2 shtesë: “Diskutim për Organizimin e 15 janarit të Masakrës së Reqakut”.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.12.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, kam vërejtje te procesverbali sepse duhet të merret nga stenogrami, unë nuk e votojë këtë procesverbal.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 22.12.2022.**

Pika 2

Diskutim për Organizimin e 15 janarit të Masakrës së Reqakut (Pikë Shtesë)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Adem Ramadani; Kërkojë që me qenë prezent kryetari dhe drejtoresha e DKRS-së këtu në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kryetari nuk mundë të jetë prezent për shkak të angazhimeve që ka, ndërsa drejtoresha është në pushim të lehonisë.

z.Përparim Ramusa; Është mirë me marrë 10 minuta pauzë dhe me na e konfirmuar se a mundet me ardhur Kryetari dhe drejtoresha në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e dhashë sqarimin për të dytë.

znj.Adelina Beqaj; Meqenëse kjo pika u aprovua atëherë kujt duhet të ju drejtohemi, ne kërkojmë pauzë deri sa të vjen drejtoresha.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, kisha me plotësuar Adelinën, se drejtoresha është në të gjitha evenimentet, por ne po marrim pauzë e po e presim drejtoreshën.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, është pikë e ndjeshme, me qenë se nuk janë askush prezent me na dhënë sqarime, kërkojë mirëkuptimin që këtë pikë ta kalojmë për mbledhjen e radhës. Kërkoj diskutim për seancën e radhës.

z.Rahman Jakupi; Nëse nuk janë prezent ata duhet me i zëvendësuar dikush. Nuk është e mundur askush mos me ekzistuar.

z.Reshat Mujota; Kështu po dalim keq te drejtoritë, e kam prit këtë mbledhje më mirë, pa përgjegjësi totale. Zyrtari i drejtorisë duhet me qenë këtu. Pajtoj që ka qenë në Patronazhin e Kryeministrat, por drejtoria e kulturës asnjë aktivitet nuk e ka bërë për "15 Janarin".

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, kemi një pikë shumë të rëndësishme për diskutim, ne po kërkojmë që ta thirrësh dikën. Kërkoj një pauzë 10 minuta.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë nuk thash që s'është pikë e rëndësishme. Ne u kemi dërguar ftesat zyrtarisht për pikat e rregullta. Atëherë po shkojmë në pauzë për 10 minuta në ora 10:04h.

Kryesuesi mbledhjen e vazhdoi në ora 10:24h. Ju kërkua 10 minuta pauzë për me qenë drejtoresha, unë edhe njëherë e konfirmoj se drejtoresha nuk do të jetë këtu, ju keni mundësi me bërë Pyetje. Ne po vazhdojmë me diskutimet.

z.Adem Ramadani; Po më vjen keq që anëtarët e vetëvendosjes e votuan "Kundër" propozimin por që ky është Kuvendi si organi më i lartë dhe mos pjesëmarrja e Kryetarit, e drejtorëve, unë kam pas vërejtje se jemi vonuar shumë edhe vërejtje për "Këshillin Organizativ" që takimi ka qenë me 5 Janar. Pse mos me u bë më herët ky organizim. Vërejtja është për organizimin por është edhe për një pikë që mua nuk mu ka dhënë fjala, edhe pse unë nuk kam pasur kurrfarë akuze, se edhe vet kam qenë anëtarë i "Këshillit Organizativ" por që tani po themi se edhe përvjetorëve tjerë fshati Reqak po kërkon nga Komuna që me qenë më e kujdeshme ndaj organizimit të përvjetorëve të tjerë për Masakrën e Reqakut, për këtë arsy e kam pa të arsyeshme për me diskutuar për këtë pikë, sepse sikurse po e shohim që Serbia po e mohon ekzistencën e Masakrës së Reqakut.

z.Reshat Mujota; Unë i kam pa disa pa kënaqësi në media pse ju ka mohuar e drejta e fjalës, meqenëse ka qenë edhe anëtarë i "Këshillit Organizativ", edhe do të ishte mirë që me na treguar sa mbledhje janë bërë dhe çka është diskutuar, a është ky protokolli i Kryeministrat që ka thënë sa më shkurtë. Ka pas mundësi që me e shkurtua një fjalim tjetër, e ma ja mundësuar banorit të Reqakut me majtë fjalim. Ky është kryetar i fshatit Reqak. Por pasi që nuk është zgjedhë ende kryetari i ri është një vërejtje për Kryesuesin e Kuvendit

z.Adem Ramadani; Në mbledhjen e parë të mbajtur me 5 janar, ka procesverbal dhe kemi pas vërejtje pse kaq afër me u mbajt mbledhja, vetëm 10 ditë para ditës përkujtimore të masakrës, është pak. Pastaj nuk ka pas logo se si ka me dalë ky përvjetor. Pastaj ftesat se si duhet me qenë. Pastaj më 10 Janar "Këshilli Organizativ" ka qenë më i zgjeruar me shoqatat nga niveli qendoror e lokal, ka pas prej RTK-së, pastaj drejtorët, unë, një përfaqësues nga presidencia dhe një zyrtarë nga protokolli, një përfaqësues nga zyra e kryeministrat. Ne kemi kërkuar me marrë fjalën, nga shoqatat që ka qenë z.Shukri Buja, edhe një përfaqësues i Reqakut nga familjet e Masakrës së Reqakut. Me 13 Janar të premten më kanë thënë nga zyra e kryeministrat, përgatiti të dhënët dhe dërgona në e-mail. Unë ua kam dërguar të dhënët, dhe pas dy ore më kanë thënë, me u tërheq prej kérkesës për fjalimet, sepse kështu kanë thënë nga Këshilli, unë ju kam thënë se nëse unë nuk e marr fjalën tërhiqem nga Këshilli. Pse është me rëndësi me marr fjalën, është me rëndësi me marr fjalën sepse: Po e them këtu se jam ushtar i UÇK-së, jam i plagosur dhe kam dajën e vrarë, po ashtu edhe 14 familjarët e mi janë dëshmitarë të Masakrës së Reqakut. Postimin tim e kam bërë në facebook pasi është kryer mbledhja përkujtimore te shtëpia e kulturës.

z.Përparim Ramusa; Fillimisht ky organizim keq ka filuar dhe keq ka përfunduar mos prezenca e kryetarit e drejtorit këtu tregon që ndihen fajtorë. Qysh minden kolegët e Vetëvendosjes me votuar kundër.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Më fal, Përparim por nuk pat këtu asnjë votë "Kundër" pra ishin 7 "Abstenim".

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për sqarimin, vërejtje ka shumë, por këngët korale me karakter fetarë dhe katolik me u kënduar aty para familjarëve nuk bën, ka reaguar edhe Bashkësia Islame në Shtime, çka i ka kushtuar me ja dhënë fjalën një banori të Reqakut dhe një luftëtarit. Ka vërejtje që mos të jetë më kështu i organizuar. Kush mundet me ditë më mirë se banori i Reqakut ngjarjen.

z.Besnik Seferi; Respekt për Ademin dhe për të gjithë familjarët e Reqakut. U përmend kush është më kompetent më shumë. Edhe unë po them se nuk është mirë me kënduar Hale-Luja në mbledhjen përkujtimore të “Masakrés së Reqakut”, unë nuk po di kujt me i thanë, sepse s’është përgjegjësi, ndoshta është “Këshilli Organizativ”, sepse ky duhet me qen përgjegjës.

z.Adem Ramadani; Faleminderit Besnik për respektin, por keni mundur me dhënë arsyetimin me votë. Nuk kemi parë ndonjë herë kështu. Kryetari është zot shtëpie, ndoshta më shumë kishte me shkuar ndonjë ilahi, edhe pse nuk kam kundër asgjë nga komuniteti katolik.

z.Besnik Seferi; Unë nuk pajtohem me fjalinë për votën time, unë nuk isha kundër por “Abstenim”, dhe thash të diskutojmë kur të gjithë janë prezent dhe ta diskutojmë. Ju lus që mos me i dhënë kahje tjetër.

z.Adem Ramadani; E dinë këtë edhe drejtorët që e kemi kërkuar skenarin, Kryetari u dashtë me këmbëngulë, sepse është zot shtëpie.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje për të gjithë banorët e Reqakut, u ndjeva e ofenduar kur u tha votuat “Kundër”. Po diskutojmë për çështje të ndjeshme. Këtë e ka organizuar Kryeministria, atje është përgjigja, zotëria e sqaroi këtë. Përkulemi para banorëve të Reqakut. Si Komunë jemi tolerantë ndaj të gjitha konfessioneve fetare. Ajo besoj se është bërë në kuadër të falënderimit të miqve tanë që ishin aty prezent.

z.Adem Ramadani; Nëse kam thënë “Kundër” kërkoj falje, ne “15 Janar” do të kemi përsëri dhe do të mësojmë nga gabimet. Për këtë pikë unë nuk jam aspak politik.

z.Kadri Emini; Në parim të gjithë ishim të diskutohet, por ne që “Abstenuam” ishte arsyaja që ne kërkuan që të shtyhet me qëllim që të ishin të gjithë prezent kur të diskutohet. Unë nuk e di që bash ja ka pamundësuar me fol, mendoj është dashur me fol.

z.Adem Ramadani; Mu fjalën ma ka pamundësuar Kryeministri. Unë mendoj se arsyaja është që i kam përmend Hashim Thaqin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin.

znj.Adelina Beqa; Shpreh respektin për gjithë familjarët e Reqakut. Ne vazhdimisht kemi pasur akademi të tjera. Ne e dëgjuam Ademin me kujdes. Për këtë papërgjegjësi që e keni si ekzekutiv nuk mund të arsyetoheni.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, është një ditë e rëndësishme që po diskutojmë, me qenë se nuk është diskutuar më herët, por me 6 janar me u mbledh “Këshilli Organizativ”, është vonë. Nuk ka ditë më madhështore se “15 Janari”, nuk ka ditë më të rëndësishme as nuk është “17 Shkurti”. Ka qenë jo seriozitet mos me qenë Kryetari këtu, dhe gjithçka me u bërë për ngut, e jo me Hale-Luja. Tha dikush kanë qenë miqtë tanë ambasadori Wolker dhe ambasadorët tjerë, unë nuk e shkeli vetin për të tjerët. Hale-Luja me u kënduar në shtëpi të kulturës, banorët e kanë pritur shumë rëndë. I keni edhe 3 organizime të tjera deri në përfundimin e mandatit, e mos të ndodhin gabime të tilla, e shpresojë të mos përsëritën.

z.Përparim Ramusa; Po i respektojmë koleget, ne nuk ju ofenduam, por ju e ofenduat veten. Ky justifikim nuk është jo ishit “Abstenim” jo ishit “Kundër” etj, ju vet e ofenduat veten.

z.Reshat Mujota; Lumni Amrushi e përmendi Hale-Luja. Ushtria e Serbisë na ka vra të gjithëve mysliman e katolik. Kërkoj që mos të ketë paraqitje të karakterit as fetar e as politik. Kryetari gjatë luftës i ka pasur 16 vjet. Te drejtoresha e DKRS-së nuk e di moshën por nuk besoj që e ka përjetuar luftën aq thellë. Kuvendi i Komunës nuk e mban një mbledhje përkujtimore. Këshilli Organizativ janë mashtruar komplet me qëllim që të hiqet fjalë e Ademit.

znj.Zejnije Veliu; U tha se është e re, pra e di unë mirë se çka po votojë, dhe e di mirë se çka është “Abstenim” e çka “Kundër”. Ju po doni me e politizuar këtë temë kaq të ndjeshme por unë kisha kërkuar që kjo çështje të jetë sa më larg nga politika.

z.Përparim Ramusa; Nëse voton për propozimin e parë do të thotë se je kundër propozimit tonë. Ti edhe 6 herë duhet me fituar për me u barazuar me neve.

z.Hamëz Tërshani; Ju si ekzekutiv nuk keni qenë në gjendje me qenë prezent dhe deshtët me marr pauzë. Drejtori i DSHP-së gjuhet prej kornerit e nuk shpjegon këtu. Sa i përket besimit unë ndihem mirë që i

takoj besimit islam, por duhet marrë parasysh që ne jemi shtet laik dhe ka qen gabim këndimi i Hale-Luja në përkujtimin e Masakrës së Reqakut. Shqetësuese është tendencia për me ndarë UÇK-në prej banorëve të Reqakut. Cili përjetim është më i gjallë se sa i banorëve të Reqakut e bashkëluftëtarit të UÇK-së. D.m.th. UÇK-ja është e mirë por jo akterët. Tendencia ka qenë me nda UÇK-në prej Masakrës së Reqakut. Është e pamundur.

z.Mahamed Ademaj; E dëgjuam me vëmendje diskutimin për Masakrën e Reqakut. Pa marr parasysh a është pozitë apo opozitë, te gjithë kanë bërë homazhe, edhe nga Shqipëria ka pasur. Ademi do ta ketë përkrahjen e plotë nëse fol si Kryetar i fshatit, e jo sipas partisë. Unë dola jashtë, sepse kisha një telefonatë nga Ambasada e Zvicrës, këtë po e them, sepse u tha këtu se gjatë votimit po ikin e po dalin jashtë. Lavdi të gjithë të rënëve.

z.Rahman Jakupi; U bë një konstatim se nuk është bërë një organizim i mirë. Këshilli Organizativ ka pas kërkesa të veta. E drejta e fjalës është themelore demokratike. Kur po vjen çështja përgatitjeve po thoni po i kemi bërë, ndërsa kur është çështja për organizim të keq po i ikni përgjegjësisë. Ademi tha konkretisht se po flas në emër të banorëve. Ademi tha se u hequr për shkak se ka dashtë me përmend Hashim Thaqin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Shumë anëtarë të Reqakut nuk kanë marr pjesë në mbledhje. Keq që as edhe një Ekspozitë nuk ka ndodhur a mund të na thoni pse nuk ka ndodhur? Tendencia për me mohuar luftën e UÇK-së, është edhe arsyaja që nuk tu ka dhanë fjala Adem. Tendencia pastaj për me bërë ndarjen e UÇK-së nga Masakra e Reqakut. Pse u bë Këshilli Organizativ. Përgjegjësia mbetet në Shtime. Unë kam shumë me fol për atë pse ju ndalua fjala Ademit.

z.Adem Ramadani; Unë e kam kërkuar pjesën e Ekspozitës, këtë e kemi pas vjet. Në Këshill Organizativ kam thënë me u mbajt sivjet. Na kanë thënë se nuk kanë nda mjete, nëse nuk kanë nda mjete unë nuk e di se e kujt është kjo Ministri a është Ministri e Kosovës a e Serbisë, unë mendoj se mundet Komuna me nda mjete.

z.Besnik Seferi; Unë e kuptojë që u tha keq menaxhim, por nuk u tha çka me bërë. Unë propozojë që ta kemi si pikë të veçantë për herët tjera, d.m.th para se të ndodhë diçka.

znj.Besartë Musliu-Spahija; Përvendetje, Lavdi për dëshmorët e këtij vendi. Unë si vajzë e dëshmorit dua ta mbështesë kolegun Ramdani, sepse ajo nuk ishte politike. Gjatë diskutimit e pash që drejtori i DSHP-së po përgeshej, drejtor nëse keni diçka me thënë thuaje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po shkojmë në pauzë deri në ora 12:05h.

Kryesuesi mbledhjen e vazhdoi në ora 13.02h.

Pika 3

Pyetje – përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Kamë këto pyetje: Pyetja e parë për zyrën e Informimit, pse në faqen e facebook-ut të Komunës nuk po bëhen njoftimet për takimet e KPK-së, kur e dimë që ky Komitet është obligator ? Pyetja e dytë për DSHP-në, kamë parë te Institucioni i Arsimit dhe aftësimit profesional pusat e kanalizimit pa kapak, por ka edhe në disa rrugë tjera kur do të mbyllen këto puseta?

znj.Albana Podvorica; Ju uroj vitin e ri 2023. Kemi një jo bashkëpunim me drejtoreshën e DKRS-së, Pyetja e parë për Kryetarin, kemi disa takime të Komitetit që i kemi mbajtur dhe drejtoresha nuk po merr pjesë në mbledhjet e KAKRS-së, a është në pushim drejtoresha e DKRS-së apo në punë? E kam pranuar një email nga z.Xhemshir Rashiti, ish drejtori i shkollës “Bajram Curri” në Petrovë ku ka thënë se Adnan Ademi e ka përmend emrin tim në mbledhje të Kuvendit dhe deklaroj se ka thënë të pa vërteta se nuk di me i mat drutë. Dhe se ato që i ka thënë Albana janë të vërteta. Po e pyeti Adnanin a tërheq fjalën apo jo?

znj.Adelina Beqaj; Me çfarë logjike ti e quan drejtorin e shkollës të paditur? Pse nuk po na vijnë kërkesat e qytetarëve në Kuvend?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Jemi duke punuar në rregulloren për punë të Kuvendit dhe Komitetve dhe kërkesat nuk do të vinë më direkt në Kuvend, por do të vinë me Rekomandim të Drejtive. Unë i kam deleguar kërkesat nëpër Drejtori, kjo është përgjigjja.

z.Përparim Ramusa; Nuk bën znj.Albana Podvoricës kështu bashkë partiakes time me ja ndal fjalën, kur pyet pse ish drejtorin e ke quajtur të paditur.

z.Asllan Beqaj; Pyetje për DSHP-në, kam vërejtur nëpër fshatra dhe lagje që ka ndriçim publik por nuk po funksionojnë, kur do të bëhet ndërrimi apo rregullimi i këtyre dritave? Pyetja e dytë për DSHP-në, si do të vepron me deponit ilegale të imbeturinave, apo a keni ndonjë plan që gjatë këtij viti ta trajtoni këtë problem, si do të zgjidhet kjo çështje, dhe kur do të filloni ti largoni këto deponi ilegale.

znj.Zejnije Veliu; Pyetje për DPUKGJ-në, kohëve të fundit e keni bërë ndriçimin në fshatin Mollopolc dhe është mirëpritur nga banorët, mirëpo ka edhe disa lagje që kanë nevojë për ndriçim, ju si drejtor a keni paraparë ndonjë projekt për fshatin Mollopolc.

z.Muahmet Ademaj; Pyetje për DPUKGJ-në, Sa është numri i lejeve të ndërtimit të objekteve shumëkatëshe, dhe sa leje janë lëshuar për vitin 2022?

z.Reshat Mujota; E falënderoj Zejnjen për interesimin që po tregon për fshatin Mollopolc. Pyetje për DKA-në, pse nuk është funksionalizuar dhe nuk është hapur shkolla Gjimnazi “Naim Frashëri” ende? Pyetja e dytë për DKA-në, pse nuk janë zgjedhur ende arsimtari i fizikës në Shkollën e Gjimnazit dhe nuk janë notuar ende nxënësit në lëndën e Fizikës?

Nepotizmi që e ka përmend Kryetari, dorëheqja e drejtorit të DKA-së a është ë lidhur me punësimin e bashkëshortes tuaj?

z.Rexhep Gashi; Nuk kam marr përgjigje në disa pyetje. Pyetja e parë për DPUKGJ-në, te rruga “Anton Qeta” dhe në rrugën “Isa Boletini” kur do të rregullohen pusetat? Pyetja e dytë për DSHP-në, çka është tu ndodh me mirëmbajtjen e trotuareve kur dihet që kemi kontratë në mënyrë të parakohshme për mirëmbajtjen e tyre në rrugën “Ibrahim Rugova” “Komandant Kumanova” dhe “Isa Boletini”? Pyetja e tretë për DKA-në, në katin e parë në shkollën profesionale janë paralizuar 4 klasë dhe kanë një vështirësi përfunksionalizimin e atyre nxënësve dhe stafit profesional? Pyetja e katërt për DKA-në, përmërtimin e ushtrues detyre në shkollën “Bajram Curri” nxënësit kanë mbet pa mësues të Gjeografisë kurse mësuesin e Gjeografisë e keni bërë ushtrues detyre kur do të bëhet një zgjidhje për këta nxënës?

z.Besnik Seferi; Pyetja e parë Te “Handikosi”, kur ata do ta kenë një zyre të punojnë, sepse janë tejet keq. Kemi 246 persona me aftësi të kufizuara. A ka plan me i sistemuar personat me aftësi të kufizuara. Pyetja e dytë për nxënësit e fshatit Mollopolc, nxënësat e kanë tejet të vështirë për transport kur do të bëhet zgjidhja e transportit përxenësit e shkollës në Mollopolc? Pyetja e katërt për DPUKGJ-në, sa janë bërë përgatitjet për sezonin dimëror, pasi qytetarët kanë hasur në disa rrugë në fshatin Pjetërshticë që kanë qenë me ngrica?

z.Lumni Amrushi; Pyetje për DSHP-në, na e keni lënë një projekt në gjysmë, u bënë 3 vite e ende nuk janë lëshuar dritat kur do të lëshohen?

z.Reshat Mujota; Ai që është duke jetuar në fshatin Mollopolc e din më së miri për nevojat e fashtit. Pyetje për Kryesuesin, pse TV “Spin” e ka tërhequr kërkesën? Ndriçimi në Mollopolc është përfunduar, mirëpo në disa lagje ka ende pa u kryer disa punë, edhe unë mund të them se i di mirë megjët e Mollopolcit. Nuk më vjen mirë me luajt popullzimin. E përkëtë çështjen e transportit të nxënësve në fshatin Mollopolc e dini mirë se kush e ka ngritur në Kuvend. Pesë herë ka konkurruar zonja Zejnije, për një vend pune në Mollopolc, por deri u bë këshilltare nuk u punësua. Dua me ju tregu se Ligji është më i madh se rregullorja.

z.Rahman Jakupi; Kamë këtë pyetje: Kërkesë për Zyren e Tatimit në Pronë, të na e sjellin një dokument lidhur me tatimin në pronë, për secilin fshat kishte me qenë shumë e mirëseardhur? Pyetja e dytë për DPUKGJ-në, deri ku ka mbërritur procesi i hartimit të Hartave Zonale?

z.Gëzim Haxhiu; Kamë këtë pyetje:

Pyetje për DPUKGJ-në, që ka të bëjë me rrugën “Ohri” në Lagjen e Pajtimit, kur parashihet rregullimi i ndriçimit?

Pika 4

Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi Rekomandimet e KPF-së dhe KPK-së. Para se të hapë diskutimin fjalën ja kalojmë z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Do të jem i shkurtër për këtë rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2023. Diskutimi publik sipas vendimit të Kuvendit ka përfunduar, me datën 16.01.2023, kemi mbajtur takim me qytetarë, pjesëmarrës nuk ka pasur shumë, dhe nuk ka pas propozime konkrete. Rregullorja është e njëjtë ju ftoj që ta aprovoni.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshtendetje, kemi një kërkesë nga K.R.M “Pastërtia” Njësia në Shtime, kështu të njëjtën gjë e kanë bërë edhe Kaçaniku edhe Ferizaji. Kompanitë publike kanë kriza financiare, mendoj se është kërkesë ligjore. Kompania që bënë grumbullimin e mbeturinave dhe e dërgon në deponi paguan, kështu që edhe ato kanë ngritje të çmimeve.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për informatën, po shihet që nuk kanë marrë pjesë dhe nuk ka propozime konkrete, nuk është mirë kur nuk ka interesim për këtë qështje mjaft të rëndësishme sepse prek gjepin e qytetarit.

z.Reshat Mujota; Sa ka qen ngritja te bizneset edhe sa te ekonomit familjare, nëse është ngrit edhe dorëzimi i mbeturinave, që e paguan “pastërtia” atëherë ne i shkaktojmë kokqarje të mëdha “Pastërtisë”.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Lexoi ndryshimet për ngritjen e çmimeve.

z.Reshat Mujota; Propozojë që të votohet me ngritje, sepse nuk është ngritje e madhe, më mirë me ngrit se me falimentuar Kompaninë.

z.Kadri Emini; Edhe unë e përkrahu Reshatin, nuk guxojmë me rrezikuar grumbullimin e mbeturinave, nuk është ngritje e lartë. Dëshirojë me ditë edhe Rekomandimin e DSHP-së.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Duke e parë situatën edhe unë jam për ngritje, sepse të gjitha komunat kanë ngritje, dhe është e pa mundur me operuar në teren. Është ngritur edhe çmimi i naftës.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për informatën, e kuqoj që ka probleme financiare por edhe qytetarët kanë probleme financiare. Mendoj se është mirë ta subvenciononi Kompaninë Publike. E udhës është që ne mos ta votojmë ngritjen e çmimit, sepse te çdo produkt janë ngritur çmimet. Propozojë që këtë barrë ta marrin Komunat.

z.Adem Ramadani; Po pajtohem me Përparimin, mendoj se ekonomit familjare duhet me i lënë me çmimin e mëparshëm.

znj.Adelina Beqaj; Nuk po mundem të pajtohem me ngritjen e çmimit për qytetarët, para se me qenë marre është gjynah. Po thoni kemi pas ngritje të buxhetit, ku jeni ju para se me marrë këtë vendim mendoni mirë, vota ime është “Kundër”.

z.Reshat Mujota; Ide e mirë çka tha Përparimi. Por Adelina njëherë thotë pse nuk po i bini kërkesat, e pastaj kthehet e thotë pse po i bini kërkesat në Kuvend, ose është për ose është kundër kërkesave, diqysh duhet me u lidh.

znj.Adelina Beqaj; Kur po flas për këtë temë me të vërtetë po kam emocion, sepse po ngulfatet xhepi i qytetarit. E i vetmi ndryshim është ngritja e çmimeve.

z.Lumni Amrushi; Propozojë që kërkesën e K.R.M “Pastërtia Njësia në Shtime me shty për mbledhjen tjetër, me shikuar a ka zgjidhje tjetër.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Shkalla e ngritjes së çmive me këtë propozim po e shohë që është 28%. Ndoshta ka mundësi me e ngrit çmimin e shërbimeve për biznese pak, ndërsa për ekonomi familjare me zbrit pak.

z.Asllan Beqa; Nuk jam kundër kërkesës të K.R.M “Pastërtisë“ Njësia në Shtime, por jemi kundër ngarkimit të qytetarëve, ne nuk kemi asnje raport financiar se si operon kjo kompani.

z.Besnik Seferi; Lexoi disa shënimë të veta për të hyrat e Kompanisë “Pastërtisë”. Më pëlqejë propozimi i Përparimit për subvencionim sepse kjo kompani po punon me humbje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; I kemi shikuar disa komuna, si Ferizaji, Kaçaniku e Podujeva, mirë nëse e shtyjmë këtë pikë, çka kemi me bërë me këtë pikë pastaj. Nëse kompania detyrohet më e rishikuar numrin e punëtoreve çka do të bëjmë ne me mbeturina.

z.Hamëz Tërshani; I dëgjova të gjithë, ekziston brengë se kur kemi të hyra nga kompania ne jemi për me përkrahë. Nuk kemi një rekomandim nga drejtoria. A ka ndonjë alternativ tjetër për mos me ngarkua xhepin e qytetarit.

z.Muhamed Ademaj; Sa është numri i ekonomive familjare që paguajnë, e sa i atyre që nuk paguajnë? Nëse ngritët për 1 euro nuk është shumë e madhe për me paguar të gjithë.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Mua më ka ardhur kërkesa në muajin shtatorë 2022, dhe e kemi pas përparrë edhe vitin e kaluar dhe e kemi diskutuar. Kjo kompani operon me humbje, ndërsa mbulueshmëria është 60 %.

z.Rexhep Gashi; Jemi me një situatë të rëndë ekonomike, a e din në çfarë gjendje ti ish drejtor (Hamëz) e ke lënë Kompaninë “Pastërtia” dhe tash po bën pyetje?

z.Hamëz Tërshani; Ka qejf Rexhepi me u kyqë, por nuk tha asgjë. Është mirë me gjet alternativë.

z.Besnik Seferi; Kemi inkasim deri në 80 % po flas për vitin 2022, duhet me pas parasysh se në çfarë gjendje është kompania “Pastërtia”. Në këtë kompani duhet me bërë një farë kontrolli bukur të madh.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Nëse shtyhet kërkesa e K.R.M “Pastërtisë“ Njësia në Shtime duhet të shtyhet edhe rregullorja. Komuna është aksionare aty. Kur po dëgjojë duke folur drejtorin e DPUKGJ-së, Grejtalbin me centë po thamë mos ka dal në LDK. Pastaj po e dëgjojmë propozimin e PDKsë që të shtyhet komplet, me arsyetimin që këtu të vjen drejtoria dhe të jep sqarime konkret. Pastaj unë mendoj se edhe Besniku duhet me pas parasysh e me na dhënë një raport, mbase është në Komisionin e bordit të aksionarëve të kësaj Kompanie.

z.Reshat Mujota; Këtu flasin kishe po e mbrojmë “Pastërtinë” e kur dalim jashtë krejt ndryshe. Unë e di se çka heqin ata punëtorë. Te tarifa për amvisërinë unë jam për me subvencionuar diqysh.

z.Kadri Emini; Në emër të grupit po deklarohem “Për” që me pas shërbime me të mira për qytetarët. Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pauzë 5 minuta për konsultim.

Kryesuesi mbledhjen e vazhdoi pas 5 minutave, dhe fillimi shërbim konstatoi kuorumin prej 21 anëtarëve, prezent në mbledhje.

z.Rexhep Gashi; Pa një raport të tillë unë nuk di qysh me votuar, e që këtë raport na ka premtuar Besniku.

z.Përparim Ramusa; Kërkojë që kjo pikë të shtyhet. Nëse ka alternativë me subvencionuar Kompaninë nuk ka nevojë me i ngritë çmimet.

z.Kadri Emini; Po na duket absurde mos me votuar një kërkësë të “Pastërtisë”. Ne jemi “Për”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 21 anëtarëve.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 9 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”** nuk e miratoi Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 12 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 7 vota “Abstenim”** vendosi që pika e 4 (Draft- Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2023, (pas diskutimit publik) të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pika 5

Raporti vjetor financiar i Komunës së Shtimes për vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Prezantoi reportin duke lexuar me tabela. Materialin e keni marrë me kohë (shih dokumentin). Nëse ka pyetje urdhëroni. Nëse kemi ndonjë ndryshim do të paraqitet në materialin e rapportit.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për reportin, është punuar mirë në përputhje me ligjin. Buxheti është shpenzuar 90.81% në rapport me alokimet, ne e përkrahim.

znj.Shkurte Musafa; Para disa muajve e kemi marrë një report që e kemi pas 35%, atëherë kemi pas thënë që në fund të vitit do të kemi shpenzim më të madh.

z.Rexhep Gashi; Kalkulimet po bëhen me përqindje, mos janë fontanë dëshirash me 31% e tani me 90%. Nuk e keni luksin kur kemi nevoja të tjera si p.sh për kanalizim. Pyetja ime është si është ngritë përqindja e projekteve?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Këtë report nuk e punoj në qytet por në zyre. Dhe e punojë me shifra, e kam obligim me potencuar dhe e potencova. Ne duhet me krahasuar me një vit tjetër si bazë. Projektet pa report të pranimt nuk e di që mundë të paguhen. Nëse keni ndonjë informatë të tillë na thuani.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për elaborim të raportit. Por që është raport i keq ne kemi paralajmëruar. Prej 8.700,000, euro Qemajlit i kanë tepruar 1 milion e 400 mijë, edhe te pagesat për paga. Në paga i kanë shpenzuar 96%, e qe tre muaj nuk ka mësimdhënës. Te projekti i kapitaleve janë shpenzuar 75%. Kryetari Aliu gjashtë muaj nuk ka mundur me kompletuar ekzekutivin. Te mallrat dhe shërbime i kanë shpenzuar 92.05%. Kjo qeverisje është e keqe, ky raport nuk mundë të ndryshohet dhe unë nuk jam i kënaqur dhe nuk mundë ta votojmë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Faleminderit për reportin. Në reportin 3 mujor i kemi pas 7 ose 8% dhe kemi arrit në 75.03%. Fatkeqësisht Komuna në qeverisjen e juaj nuk ka mundur me arrite përqindjen për grandin e performancës. Me këtë qeverisje i kemi fituar mbi 1 milion euro në grantin e performancës. Këtë ne e kemi arritur, kështu që jemi të hapur.

z.Përparim Ramusa; Ne kemi qeverisur në pandemi, çka ju ka penguar juve mos me e harxhuar buxhetin, e ti je dal i 18 në performancë dhe në këtë kohë kjo është keq menaxhim.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Në vitin 2021 vlera e shpenzimeve kapitale ka qenë diku 63 deri 65% ndërsa në vitin 2022 vlera e shpenzimeve kapitale ka qenë 75%, të gjithë e dinë me çfarë probleme janë ballafaquar kompanitë duke marrë parasysh inflacionin i cili ka ndikim shumë të madh te investimet kapitale. Ndërsa te sektori i pagave unë nuk jam i thirrur me fol për atë dikaster.

z.Përparim Ramusa; Po bëni një kahasim absurd me vitin 2021 ku ka qenë pandemia dhe nuk ke mundur me dalë as në kojshi e leje më me bë investime kapitale.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Kërkojë që të fokusohemi në këtë raport. Pyetjet janë më shumë për drejtoretë e jo përmua. Ky është raport financiar, herën tjeter do ta bijë një raport më të madh. Kërkojë që ta aproponi, sepse numrat nuk mundë ti ndryshojmë.

z.Reshat Mujota; Te huaja për projektin e kolektorit i kemi pas mbi 2 milion euro, ndërsa i kemi harxhuar vetëm 300 mijë euro. Në reportin në shtatorë mbërrin 30% të shpenzimeve ndërsa në fund të vitit e mbërrijë 75%, si është e mundur, për këtë arsyë kërkoj reportin analistik. Nuk kemi raport për nënrat lehonë sa kanë përfituar pastaj për GPS-at e automjeteve të Komunës dhe reportin për dreka dhe darka zyrtare. Në këtë mënyrë unë këtë raport nuk e votojë.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Sqaroi klauzolën për projektin e kolektorit që është me kredi. Është për qeverinë dhe kuvendin e komunës.

znj.Zejnie Veliu; Pyetje për Bujarin sa majte kanë tepruar në vitin 2021, që ta dimë më mirë se kush ka qeverisur më mirë ?

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Kundërshtimet kanë me qenë gjithmonë pa marrë parasysh se kush qeverisë, përfaktorë të ndryshëm. Raportet ndërtohen mbi bazën e fribalancit.

znj.Zejnie Veliu; Qytetarët e dinë qeverisjen e mirë dhe jo të mirë, por unë desha të shërbehem me shifra.

z.Asllan Beqaj; Faleminderit për reportin, sa i përket projekteve kapitale jemi shumë më mirë, jemi në 75%. Në vitin 2021 janë shpenzuar 50 mijë euro ndërsa në vitin 2022 janë mbi 300 mijë euro. Në vitin 2023 drejtorët duhet të performojnë. Herëve tjera na sjell një raport më të detajuar. Urojë ta shpenzoni buxhetin në vitin 2023 me 100%.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për” me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi, Raportin vjetor financiar të Komunës së Shtimes për vitin 2022.**

Pika 6

Propozim-Vendim për ndarjen 100 € për Nënët-Lehona për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi rekomandimin e KPF-së. Fjalën ja dha Isa Haxhiut.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; 25.600 euro janë rezervuar për këtë destinim, por kemi rrëth edhe 8000 mijë euro kërkesa që janë bartur nga viti 2022. Me e rritë vlerën për 200 euro nuk mundemi.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit për këto informacione, unë kam propozuar për 200 euro, atëherë më mirë të mbetet 100 euro se me na u kthyer nga MAPL-ja. Unë propozojë që ti mbështesim dy gratë kujdestare që kujdesen përfëmijët pa prind së paku nga aspekti moral.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Ne kemi pasur një kërkesë të tillë dhe unë kam menduar për ndarjen e 600 euro në dy periudha kohore mirëpo nuk kemi mundur, sepse ka pasur implikime buxhetore.

z.Benik Seferi; Është mirë që në vitin 2022 e kemi pas një vendim të tillë, propozojë që ashtu të jetë edhe për vitin 2023. Për këto dy gra kujdestare që rrisin fëmijë pa prindër, duhet të shpalen qytetare nderi për këta fëmijë. Është mirë të bëhet subvencionimi i tyre.

z.Përparim Ramusa; E falënderojë Isën për elaborim të saktë me arsyetimin që e dha e mbështhes që kjo shumë të vazhdojë të jetë edhe në vitin 2023 të jetë 100 euro.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ndarjen nga 100€ (njëqind euro) për secilën Nënë-Lehonë, për ç'do fëmijë të lindur në vitin 2023, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2022 e të cilët nuk kanë pas mundësi me paraqitur kërkesën për realizimin e të drejtës së tyre, gjatë vitit 2022.**

Pika 7

Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Nëse shkon në diskutim publik po votojmë menjëherë.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 8

Draft-Plani i Punës të Kuvendit për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2023.**

Pika 9

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit për 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi, orarin për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2023.**

Pika 10

Informatë për punën e KKSB-së gjatë vitit 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kryesuesi i KKSB-së është Nënkyetari por pasi ai ka probleme shëndetësore dhe nuk gjendet në Kosovë, e ka angazhuar z.Ibrahim Demirin që ta prezantonjë këtë informatë. Fjalën e ka z.Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, Kordinator i ZKKK; Përshëndetje, e di që jemi lodh, kështu që do të jem i shkurtë. Ashtu sipas ligjit ky është i obliguar të paraqet informatë për punën e KKSB-së. Janë mbajt 6 mbledhje të KKSB-së, materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar (shih dokumentin). KKSB-ë e ka përgatitur strategjinë për vitin 2023-2025 ku janë parapare aktivitetet. Nëse ka ndonjë pyetje, do të përgjigjem.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për informatën, sipas informatave situata e sigurisë konsiderohet e qetë dhe stabile. Duhet të bashkëpunojmë me policinë. Vendosja e kamerave do ta rrissë sigurinë.

z.Përparim Ramusa; Nënkyetarit i urojmë shërim të shpejtë, e përgëzojë për informatën.

z.Reshat Mujota; E kemi pas një farë gjurulldie a keni ndërmarrë diçka.

z.Ibrahim Demiri, zyrtarë i ZKKK; Thashë se në strategji janë paraparë aktivitetet çështja e sigurimit është rrezikuar kjo në mbledhjen e radhës do të trejtohet.

Pika 11
Raport i punës së Kuvendit për vitin 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kryesuesi e dha shkurtimisht një raport të punës së Kuvendit për vitin 2022. Dhe në vazhdim e lexi raportin (shih dokumentin). Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin, mendojë se kemi përbashkët obligimet ligjore dhe nuk ka pasur ndonjë problem.

z.Përparim Ramusa; I falënderoj të gjithë Kuvendarët për një punë të përbashkët nuk kam dëshirë të acarohemi për shkak të punës së Ekzekutivit ne nuk kemi vërejtje, por ndaj Ekzekutivit.

z.Reshat Mujota; Kemi raportin e punës tonë. Kam vërejtje te kërkesat, te formimi i komisionit u dashur që te raporti ta kemi edhe raportin e financave të Kuvendit.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2022.**

Pika 12
Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E njoftojë Kuvendin se në KPF nuk është më Heroina Selmani, sipas U.A tani duhet që ta zëvendëson Zejnie Veliu. Këtë vend vakant duhet ta plotësojmë në KPF.

z.Reshat Mujota; U.A e kam lexuar nga 20 herë. Ky ja jep të drejtën subjektit më të madh që ta ketë një anëtarë më shumë. Atëherë unë e kam pas propozuar Heroina Selmanin, e u patë bërë një rrëmujë e madhe. Ajo pat dalë si e pavarur dhe prapë u kthy. Moralisht ky vend i takton Zejnies, por unë e kam një propozim timin konkret. Unë e propozojë Rexhep Gashin që të jetë anëtarë i KPF-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë kesh shumë i qartë. E lexi nenin 3.5 të U.A .

z.Përparim Ramusa; Rregullorja e thotë që çdo propozim me qitë në votim, nëse jo ne si PDK e lëshojmë mbledhjen.

z.Kadri Emini; Një herë na e ka kthyer MAPL-ja, dhe unë kam thënë nuk ka mundësi që kjo të vendoset me vota, sepse pozita mundet me i bë votat me i zgjedhë krejt Komitete vetë.

z.Reshat Mujota; Nuk dua me bo politika shumë, unë e di se si bëhet politika, kur kam qenë në vetëvendosje, Zejnia ka qenë me listën guxo.

z.Besnik Seferi; Shumë shkurt, ne e kemi mbështet propozimin e Reshatit për Heroinën nëse doni me vazhduar punën ta votojmë kështu, por nëse nuk doni atëherë vazhdoni kështu.


z.Reshat Mujota; Replikë, ju vetë e keni propozuar Rexhen, unë po ja lëshoj vendin Zejnies në Komitetin tim ku jam.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë nuk do ta hedh në votim propozimin e Reshat Mujotes, për shkak se U.A e përcakton saktë se si duhet të zëvendësohet Heroina Selmani.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas shumë diskutimeve për pikën 12 (dymbëdhjetë) të rendit të ditës "Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së" nuk e miratoi asnjë vendim, duke e lëshuar mbledhjen e Kuvendit, në ora 16:47h, anëtarët e subjektit politik të PDK-së, si vijon: Rrahman Jakupi, Përparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, dhe Adelina Beqaj. Nga subjekti politik LB-ë Rexhep Gashi, dhe si anëtar i pavarur i Kuvendit, Reshat Mujota.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në vazhdim konstatoi se në mbledhje janë 10 anëtarë dhe nuk e kemi kuorumin përvazhdimin e mbledhjes, prandaj mbledhjen e përfundoi në ora 16:49h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi